



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.506/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Selman Salih, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rukije Matoshi, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit A.R. nga fsh. Gj. Komuna Sh., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.3494/14 të dt.21.06.2016, për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin e fillestar publik, të mbajtur me dt.09.01.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores Fatmire Cacaj, dhe të akuzuarit, me datë 10.01.2018, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

A.R., nga i ati M., dhe e ëma S., e gjinisë T., i lindur me dt. *data e lindjes*, në Gj. Komuna Sh., ku dhe jeton, me nr. personal *numri*, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i katër fëmijve, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I pandehuri A.R., me datë 22. Janar 2014, në Magurë të Lipjanit, te lokacioni “Jeta e Re”, te udhëkryqi deri sa ishte duke punuar në firmën “Kastrioti”, si pasojë e pakujdesisë së tij personat e pa identifikuar kanë vjedhur dy bateri të kamionit me targa *numri i targave*, pronë e firmës në fjalë, me ç’rast të dëmtuarit D. F. i ishte shkaktuar dëm në lartësi prej 360- €, -

-me këtë ka kryer veprën penale Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 23, 41, 42, 43, 46, 73 dhe nenit 342 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së,

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 150-€, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari D.F.nga fsh. C. Komuna Sh., udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt gjyqësore.

OBLIGOHET i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën 20-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj, PP.II.nr.3494/14 të dt.21.06.2016, e ka akuzuar të pandehurin A.R., për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar deklaroi: i propozon gjykatës që ta pranoni fajësinë, nga ana e të pandehurit, pasi që i njëjti është bërë konform neni 248 të KPRK-së, pranimi i fajësisë është mbështetur në fakte dhe prova që gjenden në aktakuzë, dhe gjatë marrjes së vendimit pranimit e fajësisë ta llogaris si rrethanë lehtësuese.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor deklaroi: e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, këtë pranim e ka bërë me vullnet të plotë pa presion, duke i kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, më tutje shton se nuk e ka kundërshtuar aktakuzën, për periudhën sa ka punuar si roje në këtë firmë ka qenë hera e parë që i kanë vjedhur dy bateri, për të cilat ja kanë ndaluar paratë nga paga e tij, e ka gjendjen e rëndë familjare, është i pa punë dhe kërkon që gjykata do ta ketë parasysh këtë si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykes, i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuzën, dhe se aktakuzën nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform neni 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimit e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes, është i pa punë, sinqeritetin e të pandehurit gjatë shqyrtimit fillestar, gjendjen e dobët ekonomike, kompenzimin e dëmit, e veçanërisht pranimit e fajësisë nga ana e të pandehurit, e si rrethanë rënduese, peshën e veprës penale, konform neni 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform neni 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform neni 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.
P.nr. 506/16 dt. 10.01.2018

Zyrtare ligjore
Rukije Matoshi

GJYQTARI
Selman Salihi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.